

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me gjyqtarin Arben Hoti, në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues, dhe sekretaren juridike Shqipe Rexhepi, në çështjen penale kundër të pandehurit L.B, për shkak të veprës penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/I. nr 37/2015 të dt. 15.11.2016, pas shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 03.07.2017, në të cilën ish-in të pranishëm Prokurori i Shtetit – Ilaz Beqiri dhe i pandehuri L.B, gjykata të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri: L.B, i biri i A dhe Gj, e gjinisë G, i lindur me dt. *data e lindjes*, në P, me vendbanim në fshatin P, Komuna P, i pa martuar, i pa punë, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal *numer personal*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse: pasi më parë ka siguruar dhe gjerë me dt. 20.12.2014, rreth orës 18:40 ka mbajtur në posedim, kontroll dhe pronësi armën e ftoftë në kundërshtim me nenin 4 par.1 nën par. 1.4.3 dhe nenin 17 par.1 të Ligjit për Armët të Republikës së Kosovës, për të cilën me ligj kërkohet leja dhe atë 1 (një) shufër gome, në atë mënyrë që ditën kritike në rr "...” p.n në P, ku ka qenë vend publik, pasi që është ndalur nga zyrtarët policor, ku me këtë rast i është gjetur arma e ftoftë-shufra e gomës e cila i është sekuestruar nga ana e policisë.

- Me këtë ka kryer veprën penale veprës penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata bazuar në nenin e lartpërmendur dhe nenet 7,17,21,41,43,49,50,51,52,73 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPRK –së, i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Të pandehurit, **L.B**, i caktohet dënim burgimi në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale, në periudhën prej **1 (një) viti**.

Obligohet i pandehuri qe te paguaj shpenzimet e procedures penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej **30 euro**, në afatin prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Komfor nenit 69 të KPRK-së dhe nenit 115 të KPPRK-së konfiskohet: arma e ftoftë- shufra e gomës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë PP/I. nr.37/2015, të datë 15.11.2016, me të cilën e ka akuzuar të pandehurin L.B, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Me datë 03.07.2017, Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar dhe mbajtur seancën fillestare në këtë çështje penale, në të cilën Prokurori i Shtetit ka lexuar akuzën PP/I.nr. 37/2015, të datë 15.11.2016, ndërsa Kryetari i Trupit Gjykues pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, të njëjtit i dha mundësinë konform nenit 246 par.4 të pranojë fajësinë ose të deklarohej i pafajshëm.

I pandehuri L.B, ka deklaruar se e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i është vënë në barrë, duke shtuar se është penduar për veprën e kryer dhe se nuk ka pasur njohuri të sakta se a inkriminohet mbajtja e një shufre të tillë.

Prokurori i shtetit- Ilaz Beqiri ka deklaruar: se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ngase pranimi është në përputhje me shkresat e lëndës, ka kërkuar nga gjykata që të pandehurin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit dhe me rastin e matjes së dënimit të merr për bazë rrethana lehtësuese dhe rënduese.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjykata ka konstatuar se janë plotësuar kriteret nga neni 248 par. 1 të KPPK-së, i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi mbështetet në provat dhe faktet që përmban akuza, siç janë: deklarata e të pandehurit dhënë në stacionin policor dhe pranë prokurorit të çështjes në PTH në Prishtinë, vërtetimi mbi konfiskimin e armës- shufrës së gomës si dhe shkresat në lëndë.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata ka pasur parasysht të gjitha rrethanat e parapara sipas nenit 73 të KPRK-së që ndikojnë në matjen e dënimit, ku si rrethana veçanërisht lehtësuese për të pandehurin mori pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pendimin e thellë të shprehur nga ana e të pandehurit, i pa punë, gjendjen e dobët ekonomike, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim burgimi me kusht si në pjesën dënuese të këtij aktgjykimi, duke marrë parasysht shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, rrethanat në të cila është kryer vepra penale, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi ndëshkimor, në kuptim të preventivës individuale, që të parandaloj të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës gjeneralë që të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve u mor komfor nenit 115 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor komfor nenit 450 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
PKR. nr.680/16, datë 03.07.2017

Sekretarja Juridike:
Shqipe Rexhepi

Gjyqtari:
Arben Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, prej momentit të marrjes së këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.